



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROCESVERBAL

Komisioni për Politikën e Jashtme

Tiranë, më 03.12.2018 ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit të punës trijavor të Komisionit.
2. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lisbonës për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtar”.
3. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Kigalit të protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”.
4. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Komisionit European për programin e veprimt të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Republika e Shqipërisë, 2014-2020, alokimet e vitit 2017".

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Andrea Marto, Elona Hoxha Adnor Shameti, Eglantina Gjermani, Ervin Bushati, Vasilika Hysi, Evis Kushi, Klotilda Bushka

Mungojnë:

Tritan Shehu, Klajda Gjoshja, Edi Paloka, Nard Ndoka, Klevis Balliu, Rudina Hajdari, Edmond Panariti

Të ftuar:

Albana Shkurta – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Elvin Lako – Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Rudina Bollano – Drejtore e Ekzaminimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Lindita Meneri – Përgjegjëse e Sektorit të Markave, Dizenjove dhe Treguesve Gjeografikë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ornela Çuçi – Zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit

Klodiana Marikaj – Drejtore e Programeve të Zhvillimit të Mjedisit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Gazmend Barbullushi – Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Daniela Çekani – Drejtoreshë e Fondeve IPA

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme, datë 3 dhjetor 2018. Në rendin e ditës kemi: miratimin e kalendarit të punës trijavore të komisionit; projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lisbonës për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtar”; projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Kigalit të protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”; projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Komisionit Europian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Republika e Shqipërisë, 2014-2020, alokimet e vitit 2017”.

Besoj se e keni parë kalendarin e punimeve të komisionit për tri javët e fundit të këtij viti. Kështu që besoj se kam miratimin tuaj për miratimin e kalendarit.

Fillojmë me projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lisbonës për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtar”.

Të ftuar për këtë projektligj janë: zonja Albana Shkurta, mirë se keni ardhur, zonja Zëvendësministre, zonja Rudina Bollano, drejtore e Ekzaminimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, zoti Elvin Lako, drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Lindita Meneri, përgjegjëse e Sektorit të Markave, Dizajnove dhe Treguesve Gjeografikë.

Zonja Zëvendësministre, fjala është për ju.

Albana Shkurta – Marrëveshja e Lisbonës është një marrëveshje e veçantë në zbatim të nenit 19 të konventës së Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale. Çdo vend anëtar i kësaj konvente mund të aderojë në marrëveshjen e Lisbonës dhe bëhet pjesë e asamblesë së unionit të Lisbonës, që ka autoritetin për të modifikuar rregulloret. Marrëveshja është nënshkruar në vitin 1958, është rishikuar në Stokholm në vitin 1967 dhe është amenduar në vitin 1979.

Marrëveshja e Lisbonës parashikon mbrojtjen ndërkombëtare të emërtimeve të origjinës në vendet anëtare të kësaj marrëveshjeje nëpërmjet regjistrimi të vetëm në Zyrën Ndërkombëtare të WIPO-s në Gjenevë. Ajo u hartuar në përgjigje të nevojës për një sistem ndërkombëtar, që do

të lehtësonte mbrojtjen e një kategorie të veçantë, siç janë emërtimet e origjinës në vende të tjera, përveç vendit të origjinës. Në mënyrë që të mund të kualifikohet për regjistrim në Zyrën Ndërkombëtare të WIPO-s një emërtim origjine duhet të ketë të siguar mbrojtje në vendin e origjinës.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është i vetmi institucion në Shqipëri që regjistron objektet e pronësisë industriale, ndër to edhe treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës.

Sipas nenit 2 të kësaj marrëveshjeje, “emërtimi i origjinës” nënkupton emërtimin gjeografik të një vendi, rajoni ose lokaliteti, i cili shërben për të përcaktuar një produkt me origjinë nga këto vende, cilësia ose karakteristikat e të cilave i atribuohen ekskluzivisht ose në thelb mjedisit gjeografik, duke përfshirë faktorët natyrorë dhe njerëzorë. Pra, këto janë produkte që i kanë fituar karakteristikat, për shembull, karakteristika fizio-kimike, biologjike etj. nga ndërthurja e faktorëve natyrorë, për shembull, tipi i tokës, gjeografia, klima, mikroklima, vegjetacioni etj., me ato njerëzore, për shembull njohuritë specifike mbi teknikat e përpunimit dhe metodat e prodhimit të produkteve në vendin e origjinës.

Mimi Kodheli – Zonja Zëvendësministre, ju kërkoj ndjesë që ju ndërpres!

Ju lutem, nuk është hera e parë që jeni këtu. Unë dua prej jush dy fjalë. Ju, si zëvendësministra, dhe nuk dua ta fillojmë ditën kështu, lexoni pafundësisht relacionin që është përpara çdo deputeti. Dua vetëm dy fjalë: pse vini këtu dhe çfarë ndryshimi do të sjellë, pra nëse duhet përditësuar aderimin, duhen shtuar artikuj për shkak të këtij aderimi? Dua thjesht dy fjali.

Albana Shkurta – Pse ka rëndësi për prodhuesit tanë ose për Shqipërinë emërtimi i origjinës?! Është një nga elementet më të cilin prodhuesit e atyre produkteve, që kanë disa karakteristika unike, mund të bëhen konkurrues jo vetëm në tregjet rajonale, por edhe ndërkombëtare. Pra, bëhet fjalë për të mbrojtur prodhuesit e disa produkteve, të cilat janë me karakter unik, sepse vijnë nga Shqipëria, nga rajone të ndryshme të Shqipërisë, të cilat u japin atyre karakteristika unike.

Mimi Kodheli – Unë e di përgjigjen, por unë do t’jua bëj pyetjen: çfarë ndodh me produktet nga jashtë që nuk e kanë origjinën, pra në produktet italiane quhet Dok, pra denominimi i origjinës? Ka shumë produkte në Shqipëri, të cilat ne i konsumojmë, që nuk e kanë këtë. Ju do të më thoni: “Jo, shiko, se është ai inspektorati, sepse kështu është, pra duhet të shkojë ai inspektorati

që ta kontrollojë”. Unë e kuptoj që ne i mbrojmë prodhuesit tanë jashtë, dhe duhet ta bëjmë këtë pafundësisht...

Albana Shkurta – Ne mbrojmë prodhuesit tanë këtu dhe jashtë, sepse emërtimi gjeografik është diçka më specifike se “Made in Albania”.

Mimi Kodheli – Nëse ne të dyja shkojmë në një treg, në cilindo, të hapur, të mbyllur, ku të duash, unë ju garantoj se 50% e produkteve nuk e kanë prejardhjen, duke filluar që nga mishi e deri te çdo produkt tjetër. Çfarë ndodh në këtë rast? Vërtet po aderojmë dhe po i ndihmojmë prodhuesit tanë që të mund të mirëpërcaktojmë origjinën, te cila tokë është rritur, çfarë bari ka ngrënë, te cila lëndinë është kullotur dhe çfarë produkti del. Madje, po të isha në vendin tuaj sot, unë si ekonomiste e vjetër që jam, do të kisha ndikuar në politikat fiskale, që produktet shqiptare të kishin çmim më të lartë se produktet e huaja, ndërkohë që është *vice versa*. Shkoni kudo në vendet e BE-së, nëse e kap produktin me dorë një prodhues grek, italian, francez dhe është 100% produkt i brendshëm, çmimi është dyfish dhe trefish. Ne këto politika fiskale nuk i bëjmë, sepse atij i kërkohet përcaktimi i origjinës. Kjo do të thotë që ai të prodhojë më pak, që të mos prodhojë me gjilpëra. Ja erdhët, e ratifikuat, e kryet, *quovadis?* Ku shkojmë? Do të thoni ju: “Do të aderohem një herë se Lisbona...”. A keni ndonjë gjë konkrete, kur vini këtu që edhe ne të kuptojmë, ose t’ju ndihmojmë që kjo për të cilën po flasim të ndodhë? Në fund të ditës, shqetësimi ynë është denominimi i gjësë, të cilën ne e futim në stomakun tonë, fëmijët tanë dhe ne vetë, sepse është shumë e rëndësishme, ndërkohë që Shqipëria është dekada mbrapa.

Albana Shkurta – Nëse mundet, ne mund të themi këtu se cilat janë avantazhet që sjell për tregun apo për prodhuesit anëtarësimi i Shqipërisë në këtë marrëveshje. Në terma konkretë: në rast se një prodhues i cili deri dje që të mbronte emërtimin gjeografik të origjinës do t’i duhej të shkonte në çdo vend, në drejtoritë e tyre përkatëse ose në autoritetet përkatëse për regjistrimin ose njohjen e emërtimit të origjinës, nëpërmjet aderimit të Shqipërisë në këtë marrëveshje, kjo gjë bëhet vetëm duke bërë një aplikim te Drejtoria e Pronësisë Industriale dhe në Drejtorinë e Patentave. Nëpërmjet regjistrimit të kjo drejtori, automatikisht ky emërtim gjeografik njihet nga të gjitha vendet që marrin pjesë në marrëveshje.

Mimi Kodheli – Ti shkon në Pekin dhe në një supermarket të Pekinit gjen birrë Stela. Kjo është e sigurt. Deri më sot, që nuk kemi aderuar në këtë fasilitet, si ia ka bërë pronari i birrës Stela të shkojë ta shesë atë në Pekin?

Albana Shkurta – Ajo është një markë, nuk është një emërtim gjeografik. Nuk po flasim për këtë.

Elvin Lako – A mundem ta sqaroj unë, meqë është pyetje teknike?

Duhet ndarë objektet e pronësisë industriale që janë marka tregtare, dizenjot, modelet, treguesit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Domethënë, për treguesit gjeografikë është një traktat ku po aderojmë sot, që ka të bëjë me mbrojtjen ndërkombëtare të emërtimeve të origjinës dhe të treguesve gjeografikë, që është akti i Gjenevës, i cili ka kaluar para disa kohësh në Kuvend. Kjo ka të bëjë me këta prodhuesit shqiptarë. Në Shqipëri ka shumë produkte që mund të etiketohen si emërtim origjine/tregues gjeografikë, sepse ne kemi kohë që luftojmë të bëjmë promovim, që të grupohen dhe të regjistrohen.

Mimi Kodheli – E kemi diskutuar edhe tek akti i Gjenevës, për shembull dhia e Hasit...

Elvin Lako – Pak a shumë ato, disa janë tregues. Ndryshojnë kur hyn puna njerëzore. Ligji ynë dhe i të gjitha vendeve përcaktojnë se mbrojtja ndërkombëtare bëhet ose me marrëveshje bilaterale ndërmjet shteteve ose aderon në këto traktate dhe quhet sikur ke bërë marrëveshje me aq vende sa kanë aderuar në këto. Konkretisht, janë rreth 28 vende, me të cilat kemi leverdi. Kjo mbron kryesisht pronarët e këtyre produkteve që ky produkt të mos vidhet, të mos falsifikohet nga dikush tjetër. Nuk ka të bëjë me cilësinë e produktit, por ka të bëjë me origjinalitetin e produktit dhe me mbrojtjen e pronarit. Duke u mbrojtur pronari dhe origjinaliteti i produktit, patjetër që mbrohet edhe konsumatori, por nuk ka të bëjë me cilësinë... Produkti ka një gjë tjetër, hyn në legjislacione të tjera.

Mimi Kodheli – Jo, nuk fola për cilësinë. Nëse unë flas për birrën, unë e kuptoj që është markë, por marka, birra ku bëhet? Birra ka disa gjëra të rëndësishme, ka ujin me të cilin bëhet, ka maltin...

Elvin Lako – T’jua sqaroj, zonja kryetare, edhe atë të Pekinit?

Mimi Kodheli – Nuk ke pse të më sqarosh mua, unë jam e sqaruar, por e bëj pyetjen që të dal tjetërkund.

Ti e di se ku merret uji për të prodhuar *Coca-Cola*-n origjinale në SHBA?! Ajo merret në Amerikën Latine dhe ka 100 vjet, dhe në disa burime specifike. Ai atje nuk e shkruan kurrë, se është ai burri i mirë, se ashtu kanë qenë punët, që ky uji, që të bëhet ajo *Coca-Cola*, siç bëhet birra,

merret tek ky vendi. Që unë ta kuptoj që kjo dhia është nga Hasi, duhet të kuptoj që ajo dhia ka ngrënë barin e maleve të Hasit, apo jo, se çfarë sensi ka ndryshe? Nuk del dot një kosovar të më thotë se kjo është dhia ime, se ka kullotur nga kjo anë e kufirit. A jam e saktë? Ju po thoni se po i ndihmojmë këta që të mos vidhet kjo gjë. Dakord, edhe mund të jetë kështu, por është vetëm për këto produkte bazike?

Elvin Lako – Ato produkte që regjistrohen si emërtim origjine ose si tregues gjeografikë.

Mimi Kodheli – Kush i regjistron?

Elvin Lako – Regjistrohen në drejtorinë tonë. Ka një legjislacion.

Mimi Kodheli – Si vijnë e regjistrohen?

Elvin Lako – Me ndryshimet e fundit që miratoi Kuvendi vjet, u bë sipas direktivës së fundit të BE-së, që këto regjistrohen nga një grupim njerëzish që merren me këtë produkt, sepse karakteristike është fakti që ky është produkt i zonës dhe jo i një individ. Këto aplikojnë pranë drejtorisë sonë, e cila e merr dhe e ekzaminon aplikimin dhe gjatë procedurës ia kalon një grupi të caktuar për të vlerësuar karakteristikat.

Mimi Kodheli – Si e ekzaminoni? Çfarë i bën ekzaminimi?

Elvin Lako – Në rastin konkret, i kalon Ministrisë së Bujqësisë, meqë po flasim për produkte bujqësore, e cila certifikon nëpërmjet një grupi të caktuar kompetentësh. Nëse vlerëson se është në përputhje me karakteristikat që ka bërë aplikimin, kthen përgjigje dhe thotë se është në rregull për të vazhduar regjistrimin dhe drejtorja vazhdon më vonë me regjistrimin. Kjo është procedurë e re, se nuk ekzistonte në të kaluarën, por bëhej një ekzaminim formal dhe bëhej nga individë. Ishte e gabuar, por kështu ishte ligji në atë kohë. Këto u rregulluan. Tani përveç mbrojtjes kombëtare, sot po përpiqemi të bëjmë edhe mbrojtjen ndërkombëtare, në mënyrë që këto produkte të jenë të mbrojtura dhe të mos vidhen. Për sa i përket cilësisë, është një tjetër gjë.

Mimi Kodheli – Fjalën e ka zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit për këtë marrëveshje!

Në fakt, lexova relacionin dhe ju ndoqa me vëmendje, zoti drejtor, dhe thatë se qëllimi i kësaj marrëveshjeje është të mbrojë produktet në nivel ndërkombëtar. Pyetja ime është: sa produkte shqiptare shkojnë në bujtinat e Kongos, Kosta Rikës, Perusë, Nikaraguas, Tunizisë, Izraelit, Koresë? Shoh se, nga 28 shtete anëtarë të marrëveshjes, vende të BE-së janë shumë pak? Unë besoj se nuk kemi vajtur deri të Nikaragua, te Peruja, Togo, Tunizia të eksportojmë?

E dyta, kishim një orë debat për buxhetin për nevoja të ndryshme. Ajo do të doja të theksoja është se kemi një buxhet shumë të vogël, nuk i plotësojmë të gjitha nevojat e njerëzve (sot është edhe Dita Ndërkombëtare e Njerëzve me Aftësi të Kufizuar). Nga ana tjetër, miratohet një projektligj, i cili nuk ka qenë në kalendarin e vitit 2018, e dyta për një sistem të Lisbonës që ka një deficit të jashtëzakonshëm të ardhurash që i janë shkaktuar dhe ky deficit duhet mbuluar me kontributet e vendeve. Pra, qëllimi këtu nuk del fare që po mbrohen produktet, por paska një deficit në vitet 2016-2017 sistemi Lisbonës dhe u kërkon shteteve të kontribuojnë! Se sa do të jetë kontributi i Shqipërisë thuhet se varet nga borxhi. Ka një kontradiktë, sepse pak më lart thoni se merret parasysh shuma e deficitit të parashikuar gjatë dyvjeçari, nëse ka, numri i vendeve të ndryshme dhe kjo. Në komunikimin që ka bërë drejtorja e përgjithshme thuhet se Shqipëria për vitet 2016-2017 do të paguajë 5 mijë e 200 franga, pjesën tjetër pastaj si do të krijohet borxhi. Cila është eficienta? Sinqerisht, nuk kisha ndër mend të flisja, por ndihem keq dhe kur mendoj që sot kemi për të diskutuar në detaje dhe, nga ana tjetër, për të mbajtur një sistem, për të cilin nuk e di çfarë fitimi ka qeveria shqiptare. Për të paguar borxhet e këtyre vendeve? Kështu thoni ju në relacion. Unë po lexoj relacionin, faqen 4, paragrafin 2: “Gjatë dyvjeçarit të mëparshëm sistemi i Lisbonës ka gjeneruar një deficit të ardhurash, i cili duhet eliminuar nëpërmjet kontributeve”. Dhe qëllimi është të paguani kontributet. Pse keni ardhur në parlament? Për të bërë përjashtim nga taksat, apo jo?! Ky është një aderim. Do të aderojmë në çdolloj marrëveshje, pavarësisht nga interesi që kemi?! Sa është numri i produkteve që çojmë në Kongo, në Tunizi etj? Më thoni, pastaj nëse do ta votoj, varet.

Mimi Kodheli – Zonja Zëvendësministre.

Albana Shkurta – Për pjesën e parë, natyrisht që lista e vendeve që janë aktualisht pjesë e kësaj marrëveshjeje nuk është shumë mbresëlënëse në kuptimin se cilat vende janë ato aty. Një ngjashmëri midis Shqipërisë dhe disa prej atyre vendeve fatkeqësisht është fakti se ne, sikurse ato, jemi ose vende në zhvillim, ose duke u përpjekur ta kapërcejmë atë fazë. Nga kjo pikëpamja, nga të gjitha vendet që janë aktualisht pjesë e BE-së është prezente Italia, Bosnja. Italia është një nga vendet që jo vetëm ka një industri shumë të zhvilluar, por ka edhe një sektor bujqësor shumë të zhvilluar dhe njihet në të gjithë botën për produktet e saj. Nga kjo pikëpamje ne nëpërmjet aderimit në marrëveshje nuk synojmë të shkojmë dhe do të kemi eksport në ato vende ku nuk mund të kemi ekspert. Ne u mundësojmë atyre, që do të aplikojnë, për të njohur origjinat e tyre. Në bazë të kësaj

marrëveshje hapet mundësia për ato vende, të cilat janë aktualisht pjesëtarë të kësaj marrëveshje ose që do të bëhen pjesëtarë të saj, sikurse çdo shtet në bazë të prioriteteve që ka e arrin këtë gjë.

Mimi Kodheli – Në vazhdim të asaj që tha zonja Hysi, nëse ne e bazojmë këtë marrëdhënie mbi baza bilaterale, pra ju përmendët me të drejtë Italinë dhe bujqësinë e saj tejet të zhvilluar e cilësore, ne mund ta kemi bilaterale marrëveshjen me Italinë, ose nuk do të na i shënioni këto emra këtu në relacion dhe duhet të jeni të zgjuar mjaftueshëm që të mos na “provokoni” me këtë gjë, sepse nuk më intereson fare të kem një marrëveshje në këtë drejtim me një shtet si Tongo, me gjithë respektin për shtetin. Pra, në qoftë se në listën e të gjitha shteteve që kanë aderuar në marrëveshjen e Lisbonës kemi vetëm Italinë dhe Malin e Zi si dy vendet më të afërta që na interesojnë, ne këtë marrëdhënie mund ta zhvillojmë dhe ta perfeksionojmë mbi bazën e bilaterale, t’i ma njeh, unë ta njoh. E keni më të thjeshtë gjënë se sa duke aderuar në një strukturë. Problemi nuk janë 5 mijë frangat zvicerane, sepse ne kemi aderuar në shumë struktura të tjera, të cilat në mënyrë absolute nuk kanë asnjë funksion dhe përsëri nuk dimë t’i listojmë se ku i kemi, sepse i harrojmë rrugës. Problemi është që ne duam qumështin e dhisë, djathin e dhisë së Hasit ta njohin në Itali, Gjermani, në Francë, ku të pish qumësht dhie kushton sa frëngu pulën apo në vende ku ne mund ta çojmë si bazë të parë për t’u përpunuar. Po dolëm në ndonjë vend jashtë këtyre kufijve europianë, lum si ne. Po marr Kinën, meqë e kemi pasur vëlla të madh deri diku dhe ata ruajnë ende shumë respekt për ne. Pra, ka një shqetësim të drejtë zonja Hysi në këtë drejtim.

Elvin Lako – E kuptoj shqetësimin e zonjës Hysi. Dua të bëj një sqarim me dy-tri fjali. Ky është një nga traktatet e WIPO-s. Po ju përmend një traktat tjetër të WIPO-s, që është traktati i Madridit dhe ne si shtet krijojmë të ardhura rreth 700-800 mijë franga në vit, të cilat i vijnë shtetit shqiptar dhe kalojnë nëpërmjet buxhetit, pastaj e miraton qeveria se çfarë përdorim ne dhe çfarë derdhet ne buxhet të shtetit. Kjo drejtori i sjell çdo vit rreth 1 milion euro të ardhura buxhetit të shtetit, përveç shpenzimeve të saj. Domethënë, këtë shpenzimin, për të cilin ju sapo folët, e kemi analizuar me vëmendje, sepse nuk mund të sjellim...

Vasilika Hysi – Ti thua se e kam te 5 mijë e 200 frangat?! Jo, e kam shumë më parimore.

Elvin Lako – Ta mbaroj, pastaj.

Vasilika Hysi – Jo, drejtor, përderisa e keni pasur kaq të rëndësishme, pse nuk e keni futur te kalendari i qeverisë, sepse thoni: “Projektligji i hartuar nuk është planifikuar në programin analitik”, apo keni bërë edhe një rrugë jashtë shtetit dhe ju kanë thënë se kemi ca borxhe dhe duhet të aderoni, që edhe ju të merrni ca lekë?!

Ervin Lako – Jo, nuk ka lidhje fare.

Vasilika Hysi – Pse nuk është në program? Sa janë produktet urgjente që duhen brenda vitit 2018?

Ervin Lako – Ndoshta ka qenë në PKIE.

Zonja Hysi, ajo është miratuar në Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale me vendim qeverie, është në program, ka 2- 3 vjet që është miratuar.

Mimi Kodheli – Është futur me procedurë të përshpejtuar.

Ervin Lako – Është tjetër procedura.

Vasilika Hysi – Cila është urgjenca? Janë dy procedura: situatë e jashtëzakonshme dhe urgjenca. Çfarë humbet qeveria shqiptare? Sa produkte nuk janë regjistruar, që duhen mbrojtur?

Ervin Lako – Zonja Hysi, më lër ta sqaroj. Ka një nismë të qeverisë për të mbrojtur treguesit gjeografikë, që ne mendojmë se Shqipëria potencialisht është e pasur me tregues gjeografike dhe mbrojtja ndërkombëtare bëhet në këtë formë. Tani, disa nga vendet që renditi zonja deputete, vërtet nuk kanë afrimitet me ne si pozitë gjeografike apo ne mbase nuk mund të kemi ndonjëherë marrëdhënie tregtare...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por e dini pse janë këto?! Këto vende në botë janë të pasura me tregues gjeografikë. Po ju them vendet e rajonit. Europa dhe Amerika Latine janë vendet më të pasura.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Serbia, Sllovakia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Hungaria, Italia dhe Franca, pra janë të gjitha vende europiane.

Po ju them se tek akti i Gjenevës, që është akti që përmirëson marrëveshjen e Lisbonës, tani është duke aderuar edhe Komisioni Europian, që do të thotë: automatikisht të gjitha vendet hyjnë. Nëse kjo skemë deri dje ka qenë me një minus 2 mijë euro, nesër do të jetë me një plus.

Së fundi, aplikantët shqiptarë nëpërmjet një aplikimin të vetëm, do të kursejnë para dhe do të krijojnë mbrojtje në të gjitha vendet se sa të bëjnë aplikime në secilin vend, që është kosto për ta.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Urdhëroni!

Elona Gjebrea – Në fakt, kam dy pyetje, në vijimësi të asaj që tha edhe zonja Hysi. Këtu thuhet se është caktuar kontributi që do t'i jepet Malit të Zi, pak a shumë, 5 mijë e 200 franga

zvicerane, dhe që Shqipëria është pak a shumë në të njëjtën klasë detyrimesh. Ndërkohë, nga ana tjetër, në fjalinë e fundit thuhet: “Do t’i paguajë detyrimet Shqipëria nisur nga fakti se ky sistem është i paqëndrueshëm financiarisht”. Pyetja që unë kam është: cila është shuma që ka detyrim të paguajë Shqipëria? A kemi në rritje të detyrimit në vitet që vijnë?

Ervin Lako – Është bërë një llogaritje, sepse ne kur do të aderim patjetër që i vlerësuam të gjitha rrethanat. Për shkak se këto janë traktate, sidomos ai i Gjenevës, pra traktate të reja që vendet janë duke aderuar dhe, siç ju thashë tani po aderim edhe Komisioni Europian, për shkak të numrit të pakët të vendeve dhe të procedurave që krijojnë mbrojtje dhe ka staf që paguhet atje në WIPO, gjithë këto vite ka pasur një shumë të vendeve anëtarë që varion rreth 300-400 mijë lekë të rinj në vit, pra i takon Shqipërisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sot parashikojmë që në një të ardhme, kur do të aderojmë edhe Komisioni dhe do të ketë më shumë produkte, kjo do të jetë një gjë me fitim, siç janë të gjitha traktatet e WIPO-s. Ajo është një fazë transitore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne mendojmë se kjo skemë është me fitim, si të gjitha traktatet që ka WIPO. Unë po ju them se nga traktati i markave të Madridit, që është një nga traktet e WIPO-s, Shqipëria fiton rreth 700-800 mijë franga çdo vit, që edhe kjo do promovim. Domethënë, produktet e huaja, që kërkojnë mbrojtje për Shqipërinë, sa më shumë të provohesh aq më shumë produkte hyjnë. Këto 700-800 mijë, mund të bëhen 1 milionë franga e me radhë. Pra, çdo gjë ka të bëjë me promovimin, ka të bëjë me numrin e produkteve. Për shkak se numri ka qenë i ulët dhe për shkak të pjesëmarrjes, sepse shtetet po aderojnë ndërkohë, kanë qenë me këtë humbje në deficit, që ne e kemi shkruar për të pasur ju një ide, por nuk quhet ndonjë humbje e madhe dhe buxheti ynë e përballon plotësisht atë, nuk kërkojnë lekë nga buxheti i shtetit. Këto janë pjesë të procedurave, të traktateve të WIPO-s, njëra të merr 2 mijë franga, njëra të jep 800 mijë franga, por rëndësi ka që nuk ka ndonjë problem financiar. Ne po përpiqemi që prodhuesit shqiptarë të konkurrojnë lirshëm në treg, të kenë produktet e tyre të mbrojtura dhe treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës së Shqipërisë të bëhen të njohura nëpër botë, dhe kështu merr emër dhe vendi. Nuk është ndonjë tarifë e madhe për shtetin nëse aplikantët shqiptarë, të cilët do të jenë një grup njerëzish, siç ua shpjegova do të bëjnë një aplikim të vetëm dhe do të fitojnë mbrojtje për të gjithë ato vende, sepse ju kursen kohë, para, mund dhe jokonflikte.

Elona Gjebrea – Pse nuk e shkruani këtë në relacion: nuk ka implikime nga buxheti i shtetit, sepse e gjithë kjo krijon një konfuzion?

Ervin Lako –Nuk kemi pse ta shkruajmë nga buxheti, sepse ne jemi institucion jobuxhetor.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Elona Gjebrea – Ju duhet të na sqaroni, sepse pyetja e parë që bëhet është: a ka implikime buxhetore? Sepse sot po kalojmë buxhetin nen për nen.

Ervin Lako – Nuk ka asnjë implikim buxhetor.

Mimi Kodheli – Zotërinj, mendoj se kjo është edhe një lloj kërkesë në daç merreni shoqërore dhe në daç merreni si obligim zyrtar, sepse se relacioni për Lisbonën është pothuajse *copy past* i relacionit për Gjenevën.

Së dyti, jepni shumë detaje të panevojshme, ndërkohë mund të jepni disa të dhëna, që e ndihmojnë parlamentarën të miratojë atë që më pas juve nesër do t'ju thjeshtojë punën dhe për pasojë ju shton punën edhe prodhuesit shqiptarë. Pra, mundohuni të jeni më pak burokratë.

Kjo është në respektin tonë dhe në respekt të punës suaj. Bëni një *copy paste* listoni atje dhe silleni, në daç ta lexojmë dhe në daç mos ta lexojnë. Ndonjëherë mund të ndodhë që nuk miratohet, jo për faktin se nuk keni sjellë një projekt të mirë dhe nuk jeni duke punuar mirë, por për faktin se keni prezantuar në mënyrë rutinë, duke menduar se është një marrëveshje, duke mos parë ju, nga ana juaj, asnjë arsye pse nuk duhet ta kalojmë.

Në fakt, ne, modestish, këtu nuk jemi noterët e qeverisë, tuajt jo e jo, por as të qeverisë, meqenëse nuk ka asnjë përfaqësues të qeverisë, pa dyshim është zëvendësministrja. Këtu jemi për t'u sqaruar, që më thjesht mund të sqarohemi nëpërmjet relacionit, jo duke hyrë në detaje. Po ju them një sekret të vogël, si një njeri modestish me eksperiencë, nuk është nevoja të listohen Tongot e mundshme, sepse mund të listoni vendet që duhet që mund ta sqaroni edhe këtë gjë: në Gjenevë po përgatitet marrëveshja që e gjithë BE-ja të aderojë, dhe më pas ne të vazhdojmë vazhdimin. Pra, këtë që thatë ju, më koncize, por që të shkojmë atje ku duhet. Në fund të ditës ne jemi të gjithë këtu duke përmirësuar të gjithë kuadrin ligjor, për t'ju afruar sa më shumë *acquis communautaire*. Do të vijë dita që edhe ne mund të na interesojë edhe Tongo, por në fillim do të na interesojnë vendet e BE-së. Italia aderon më përpara BE-së për arsye specifike. Vendet e BE-së janë skeptike për mënyrën se si lahet dhia në Has, apo jo?

Ervin Lako – Varet cili vend ka produkte, ka tregues gjeografikë, sepse nuk kanë të gjitha. Shqipëria është vend i pasur me tregues gjeografikë dhe Italia, edhe Franca prandaj janë aderuar edhe Franca, edhe Italia.

Mimi Kodheli – Patjetër, por ka vende, si Greqia që çdo produkt, këtu nuk flas këtu se në cilën tokë ha dhia, nëse e ha në tokën greke apo tokën turke shkurren, por që çdo produkt turk e ka stampuar si të jetë grek. *Feta çhese* dhe kosi, meqenëse ju jeni të standardeve, nuk janë produkte greke, por produkt bullgar, por ka një enzinë që e prodhon, që quhet bullgari gumb.

Në rregull.

(Diskutime pa mikrofon)

Pra, mundohuni të na respektoni edhe neve, duke sjellë një relacion me faqe gjithfarësojesh dhe sigurisht ne do të ngatërrohem, sepse ju e gjeneroni relacionin, ministrat vetëm firmosin. Ministri nuk ka kohë të lexojë se çfarë firmos, kurse ne kemi kohë.

Unë mendoj që të kalojmë në votimin e projektligjit në parim.

Kush është dakord me projektligjin në parim? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim projektligjin në votim në tërësi.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit dhe punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROCESVERBAL

Komisioni për Politikën e Jashtme

Tiranë, më 03.12.2018 ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Kigalit të protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Andrea Marto, Elona Hoxha Adnor Shameti, Eglantina Gjermeni, Ervin Bushati, Vasilika Hysi, Evis Kushi, Klotilda Bushka

Mungojnë:

Tritan Shehu, Klajda Gjoshaj, Edi Paloka, Nard Ndoka, Klevis Balliu, Rudina Hajdari, Edmond Panariti

Të ftuar:

Ornela Çuçi – Zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit

Klodiana Marikaj – Drejtoreshë e Programeve të Zhvillimit të Mjedisit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Mimi Kodheli – Kalojmë te projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Kigalit të protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”.

Të ftuar kemi zonjën Ornela Çuçi, zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit, dhe zonjën Klodiana Marikaj, drejtoreshë e Programimit të Zhvillimit të Mjedisit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

(Diskutime pa mikrofon)

Urdhëroni, zonja Çuçi!

Ornela Çuçi – Faleminderit, që na jepni të drejtën e fjalës, sepse është mirë që, pas një provimi të gjatë që kaluam me këta, dhe të paktën ne e kemi me më pak emocion. Atëherë, protokoli i Montrealit është miratuar në vitin 1985 dhe ka të bëjë me substancat ozonholluese. Në fakt, kjo konsiderohet si një nga traktatet më të suksesshme sot në botë, i ratifikuar nga 197 shtete, si pasojë e të cilit, që nga momenti që është ratifikuar e deri më sot, është zvogëluar 99% e substancave ozonholluese në të gjithë globin dhe për pasojë janë zbutur ndryshimet klimaterike ose janë zbutur të gjitha ndryshimet e ndotjes globale.

Ne e kemi ratifikuar në vitin 1999 dhe deri tani kemi ratifikuar 4 amendamente, që kanë dalë. Arsyeja pse dalin amendamentet është se të dhënat shkencore ndryshojnë. Në kuadër të kësaj ky protokoll dhe ky traktat bëhet më i fortë dhe më shumë në mbrojtje të mjedisit.

Për sa i përket amendamentit të fundit, që ju kemi sjellë për të ratifikuar, atë të Kigalit, ai ka të bëjë me florokarbonet, që janë reduktimi në përdorimin e gazeve të florifikuara, të cilat kanë qenë pjesë e anekseve të Montrealit, por tashmë, duke e parë si një nga substancat, të cilat janë shumë më të rëndësishme edhe se dioksidi i karbonit për sa u përket shtresave të ozonit, tashmë janë futur në një amendament të veçantë, pra ky i Kigalit.

Shqipëria, nëpërmjet këtij amendamenti, merr përsipër që substancat e hidro-klorokarburet që kontribuojnë në qëndrueshmërinë në përputhje me axhendën për qëllime të qëndrueshme të vendeve tona, të ulen në maksimum, të kufizohet tregtia e këtyre nëpërmjet shteteve palë dhe atyre jopalë. Parashikohet kontrolli i substancave të listuara për shkak të ndikimit të tyre në atmosferë, siç e thashë që është zbuluar që rrjedh nga substancat më të rrezikshme. Miratimi i teknologjive të reja do t’i mundësojë vendet palë të fitojnë avantazh konkurrues në treg, pasi shumë prej teknologjive alternative të zhvilluara kanë ndikuar në rritjen e eficiencës së energjisë dhe në përmirësimin e cilësisë së produkteve.

Dua të specifikoj se nuk kemi kosto financiare në buxhet për sa i përket gjatë këtij ratifikimi dhe përmes këtyre fondeve, që janë të vendosura nga shtetet më të mëdha donatore për çështjen e këtij protokoll, ne do të presim të marrim fonde përmes projekteve të agjencive zbatuese.

Mimi Kodheli – A keni pyetje dhe diskutime? Nuk kemi.

Atëherë, kalojmë në votimin e projektligjit në parim.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin e projektligjit në tërësi.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit dhe punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

Tiranë, më 03.12.2018 ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Komisionit Europian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Republika e Shqipërisë, 2014-2020, alokimet e vitit 2017”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Andrea Marto, Elona Hoxha Adnor Shameti, Eglantina Gjermani, Ervin Bushati, Vasilika Hysi, Evis Kushi, Klotilda Bushka

Mungojnë:

Tritan Shehu, Klajda Gjoshja, Edi Paloka, Nard Ndoka, Klevis Balliu, Rudina Hajdari, Edmond Panariti

Të ftuar:

Gazmend Barbullushi – Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Daniela Çekani – Drejtoreshë e Fondeve IPA

Mimi Kodheli - Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Komisionit Europian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Republika e Shqipërisë, 2014-2020, alokimet e vitit 2017”.

Të ftuar kemi zotin Gazmend Barbullushi, sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, dhe zonjën Daniela Çekani, drejtoreshë e Fondeve IPA. Mirë se erdhët, zotërinj!

Urdhëroni, zoti Barbullushi, dy fjalë për projektligjin!

Gazmend Barbullushi – Përshëndetje!

Kjo marrëveshje është nënshkruar nga Komisionit Europian, Maqedonia dhe Shqipëria brenda këtij viti 2018. Alokimet për vitin 2017 do të financohen nga një grant i BE-së nëpërmjet instrumentit IPA II, në një vlerë prej 1 milion e 190 mijë eurosh për të dyja vendet, duke marrë parasysh bashkëfinancimin shkon në 1 milion e 400 mijë euro paketa e financimit. Në total i gjithë programi 2014-2020 kap shifrën 11 milionë e 900 mijë euro. Hapësirat ku do të zbatohet programi janë rajonet në Maqedoni: (Pelagonia, Pollogu dhe ai Jugperëndimor, kurse e në Shqipëri janë qarqet: Dibër, Elbasan dhe Korçë. Synon bashkëveprimin midis dy vendeve dhe nxitjen e bashkëpunimit, si dhe adresimin e problemeve të rajonit ku zbatohet.

Tri janë drejtimet kryesore ku zbatohet ky program: nxitja e turizmit të kulturës dhe trashëgimisë kulturore, mbrojtja e mjedisit, si dhe rritja e konkurrencës, biznesit dhe tregtisë. Është bërë thirrja e parë e këtij programi në shtator të vitit 2016, pra bëhet fjalë për alokime të një viti më parë.

Mimi Kodheli – Po, i kemi diskutuar.

Gazmend Barbullushi -Thirrja e dytë do të bëhet brenda këtij viti, domethënë brenda këtij muaji. Në thirrjen e dytë, dy janë prioritet: turizmi, trashëgimia kulturore dhe natyrore, si dhe mjedisi, parandalimi dhe premtimi i risqeve. Këto do të ishin zonat kryesore të projektit.

Mimi Kodheli – Kam një pyetje shumë të shkurtër. Ne nëpërmjet detit dhe, për fat të keq, eksportojmë mbeturina në bregdetin e Malit të Zi. Në këto projekte, a ka ndonjë mundësi që dikush të merret, meqenëse flitet për mjedisin, meqenëse flitet për komshinjtë, dhe të ketë në qendër të vëmendjes elemente, sepse janë shumë problem për Malin e Zi dhe për Kroacinë plehrat dhe mbeturinat, edhe spitalore, që vijnë për shkak të rrymave detare që vijnë nga bregdeti shqiptar në bregdetin e tyre?

Daniela Çekani – Përveç këtij programi, sepse në këtë rast ne po flasim për programin me Maqedoninë, shpeshherë është diskutuar për t’u ndërmarrë një iniciativë e tillë nga vetë institucionet lokale, që janë të interesuara direkt për përmirësimin e zonave dhe për të zgjidhur probleme, të cilat gjithmonë janë konsideruar të qenësishme edhe me një impakt, sidomos për sa i përket turizmit. Një iniciativë e tillë më konkrete është në kuadrin e një programi tjetër, kur kemi edhe vende anëtare prezente, në kuadër të programit “Adrion”. Gjithmonë është njohur si problematikë, por jo në këtë program, për momentin, përveç iniciativës, ndoshta edhe në thirrjen që hapet së shpejti, nga bashkitë respektive kërkohet që të merren në konsideratë.

Mimi Kodheli – Merr pjesë Dibra dhe programi është për mjedisin. Tani a keni qenë ndonjëherë në Dibër? Nuk afekton Dibra probleme mjedisore të qenësishme, mund ta afektojë ndoshta minierat, meqenëse janë në Dibër.

Daniela Çekani – E qartë, por ky është një proces programimi që ka ndodhur....

Mimi Kodheli – Domethënë, afektohet nga probleme të mjedisit Pogradeci apo Ohri, nga ana tjetër, sepse dëmtohet liqeni, peshku, por Dibra për mjedisin?! A keni qenë ndonjëherë në Dibër?!

Daniela Çekani – Prandaj thashë se ne koordinojmë 8 programe dhe secili ka zona të lejueshme të ndryshme nga të tjerët për të krijuar.

Mimi Kodheli – Ju shkoni aty për të ndenjtur dhe për të parë, a bëhet ky program, ah sa bukur po i firmosim këto letra ...

Daniela Çekani – Jo, vlerësimi i programit kalon në disa faza dhe kjo ka ndodhur gjatë periudhës 2013. Ka pasur ndërhyrje nga ekspertistë të huaj, që janë marrë për të hartuar këtë program.

Mimi Kodheli – Zonjë, kam njohur pak të huaj më të zotë se vetja ime, që ta dish edhe për herë tjetër, ja ku e ke zotin Barbullushi dhe mund të thotë të njëjtën gjë në subkoshiencën e tij. Tani, boll me ata të huajt, se u lodhëm!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Daniela Çekani – Dakord, por ekspertiza e huaj është në bashkëpunim me institucionet shqiptare.

(Diskutime pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Zonja dhe zotërinj e hedhim në votim projektligjin? Kush është dakord me projektligjin në parim? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim projektligjin në votim në tërësi.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit dhe punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

